



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** Dega e Leximit dhe Menaxhimit te Matjes / Sektori I Leximit.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Koordinon dhe mbikqyr ndarjen e zonave te leximit, radhes se leximit me qellim arritjen e eficenses se procesit te leximit
- Kontrollon ngarkesen per lexues sipas llojit te leximit dhe ndarjes gjeografike
- Pergatit evidentimin e leximeve te matesve te bilancit – ne nivel Box-i, Kabine, Fider, N/St.
- Pergatit grafikun e leximeve ne Nst, Fidera dhe Kabina me qellim evidentimin e bilancit te energjise
- Mbikqyr grafikun e leximeve te energjise se hyre ne rrjet si dhe te gjithe konsumatoreve fundore dhe siguron respektimin e tij.
- Kontrollon sasine e konsumeve sipas grafikut dhe organizon kontrole te leximit per konsumatoret me konsume te dyshimta te cilet nuk kane mbetur ne filtrat e leximit.
- Kontrollon cilesine e leximit nga lexuesit
- Mbikqyr sinkronizimin e leximeve te percjella ne sistemin e evidencave te leximit ne menyre periodike
- Validon leximet e mbetura ne filtrat e leximit, realizimin e kontrollit te ketyre leximeve dhe cilesine e dokumentacionit per rileximet e realizuara sipas procedurave te miratuara.
- Monitoron dhe ndihmon ne bashkepunim me sektoret e tjere te menaxhim matjes per zgjidhjen e anomalive te konstatuara nga lexuesit gjate procesit te leximit.
- Pergatit dokumentacionet e nevojshme per zgjidhjen e problemeve te leximit si rezultat i keq leximit te kryer nga lexuesit.
- Pergatit disponimin e bazes se nevojshme materiale per lexuesin: PDA, PV per evidentimin anomalive, minutazh komunikimi, pikat e kontaktit per rastet e evidentimit te cenimit te sistemit te matjes (individual apo kolektiv)



- Kryen kontrolle ne terren te anomalive te zgjedhura nga lexuesit.
- Raporton ecurine e procesit te leximeve dhe grafikut te realizuar
- Evidenton rastet e mosplotesimit te detyrave nga ana e lexuesve dhe propozon masat administrative ndaj tyre tek eprori i drejtperdrejte.
- Monitoron per Zonat e Sherbimit:
- Ekzekutimin/realizimin e Leximit të matësve të energjise elektrike bazuar në grafikun e marrë dhe dokumentimin e veprimeve bazuar në procedurën përkatëse
- 1. Ekzekutimin/realizimin e Kontrollit të Leximit të matësve të energjise elektrike bazuar në grafikun e marrë dhe dokumentimin e veprimeve bazuar në procedurën përkatëse
- 2. Kontrollon bjerjen e energjise se hyre ne rrjet dhe rakordon te dhenat me specialistin e bilancit
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.